



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM
Nr. 133, datë 18.03.2026
PËR

**PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PÛRKOHSHËM ME
PËLQIM PËR GJYQTARIN ZNJ. MATILDA FETAU**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 540, datë 25.09.2024, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të gjyqtarit znj. Matilda Fetau”, vendimin nr. 653, datë 23.09.2025 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim të znj. Matilda Fetau në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari i transferuar me pëlqim, të jetë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin znj. Matilda Fetau.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 18.03.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit znj. Matilda Fetau sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR